

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1226 Prot.

Tiranë, më 05.12 2016

VENDIM Nr. 129, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi Kërkesën për shqyrtim të propozimit të subjektit "Berat Trade" sh.p.k., në lidhje me segmentin e kolektorit, të zbuluar gjatë zbatimit të projektit "*Objekt me funksione tregtare*" godina e ish *Markatës, Berat*, depozituar pranë ASHA nga IMK,

VENDOSI:

1. Të dokumentohet nga ASHA kolektori, në segmentin e zbuluar gjatë zbatimit të projektit "Objekt me funksione tregtare" godina e ish Markatës, Berat, më pas të devijohet, sipas zgjidhjes teknike, e cila të shqyrtohet në KKR.
2. Projekti "Objekt me funksione tregtare" godina e ish Markatës, Berat, i cili pasqyron propozimin e subjektit "Berat Trade" sh.p.k., në lidhje me segmentin e kolektorit, të zbuluar gjatë zbatimit të tij, të kalojë për shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO